

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE**

POZITA E EKONOMISË SË KOSOVËS NË KONKURRENCËN GLOBALE



**PRISHTINË
2023**

Ekipi i projektit

Akademike Justina Shiroka-Pula

Akademik Isa Mustafa

Akademik Hivzi Islami

Anëtar korrespondent Besnik Krasniqi

Prof. dr. Muhamet Mustafa

Dr. Alban Hashani

Dr. Liridon Kryeziu

Msc. Gent Beqiri

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
POZITA E EKONOMISË SË KOSOVËS LIDHUR ME AFTËSINË KONKURRUESE GLOBALE	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME.....	7
1. VËREJTJET HYRËSE DHE OBJEKTIVAT	9
2. VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME PËR METODOLOGJINË	11
3. POZITA E KOSOVËS NË KONKURRUESHMËRINË GLOBALE	13
3.1. Mjedisi mbështetës	14
3.2. Kapitali njerëzor	16
3.3. Tregjet.....	16
3.4. Ekosistemi i inovacionit	17
4. KONKURRUESHMËRIA E KOSOVËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR	19
4.1. Mjedisi mbështetës	19
4.2. Kapitali njerëzor	20
4.3. Tregjet.....	20
4.4. Ekosistemi i inovacionit	21
SHTOJCAT.....	23
SHTOJCA 1: KONKURRUESHMËRIA E KOSOVËS DHE KRAHASIMI RAJONAL.....	23
SHTOJCA 2: PËRKUFIZIMI DHE QASJA METODOLOGJIKE LIDHUR ME SHTYLLAT DHE NËNSHTYLLAT	31
SHTOJCA 3: METODOLOGJIA	60
SHTOJCA 4: REFERENCAT.....	63

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Sektori dhe madhësia e biznesit.....	12
Figura 2: Pronësia dhe gjinia e pronarit	12

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Renditja e përgjithshme	13
Tabela 2: Mjedisi mbështetës	15
Tabela 3: Kapitali njerëzor	16
Tabela 4: Tregjet.....	17
Tabela 5: Ekosistemi i inovacionit	18
Tabela 6: Mjedisi mbështetës	19
Tabela 7: Kapitali njerëzor	20
Tabela 8: Tregjet.....	20
Tabela 9: Ekosistemi i inovacionit	21
Tabela 10: Konkurrueshmëria e Kosovës	23
Tabela 11: Konkurrueshmëria e Kosovës: Krahasim Rajonal	27

PARATHËNIE

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, me Programin e Punës për vitin 2022 parashikoi realizimin e projektit dyvjeçar: ZHVILLIMI I AFTËSIVE KONKURRUESE TË EKONOMISË SË KOSOVËS. Projekti synon t'i kontribuojë ndërtimit të një qasjeje integruese të masave në fushën e politikëbërjes, kërkimeve shkencore dhe aktiviteteve biznesore për nxitjen e inovacioneve dhe rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, si dhe të sektorëve të caktuar brenda saj, me kapacitete strategjike të dallueshme dhe relevante, me këto objektiva specifike:

- Përmirësimi i informacionit lidhur me nivelin e aftësisë konkurruese të Kosovës në nivel të ekonomisë dhe sektorëve të caktuar;
- Ndërtimin e indeksit të konkurrueshmërisë së Kosovës dhe analiza krahasimore me vendet e tjera dhe me gjerë;
- Propozimi i rekomandimeve lidhur me masat dhe politikat për zhvillimin e aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës.

Projekti përmban aktivitete të shtrira në dy vite për shkak të kompleksitetit të fushës së studimit dhe punës në terren.

Ekipi i projektit: akademike Justina Shiroka Pula, udhëheqëse, akademik Isa Mustafa, akademik Hivzi Islami dhe anëtar korrespondent, Besnik Krasniqi, drejtuan projektin në dy fusha relevante:

a. përgatitjen dhe botimin e një përmbledhjeje shkencore për strukturën e ekonomisë së Kosovës dhe aftësinë konkurruese të saj mbi bazën e hulumtimeve shkencore, njohurive më të reja, literaturës dhe dokumenteve relevante nga kjo fushë, me pjesëmarrje të studiueseve ndërkombëtarë dhe vendorë;

b. Raporti hulumtues për pozitën e ekonomisë së Kosovës në aftësinë konkurruese globale, i bazuar në të dhënat nga anketa me biznese për ndërtimin e indeksit të konkurrueshmërisë së Kosovës, në bashkëpunim me prof. dr. Muhamet Mustafa, dr. Alban Hashani, dr. Liridon Kryeziu dhe msc. Gent Beqiri, si ekspertë të njohur të kësaj fushe, sipas kriterëve që i zbaton Forumi Ekonomik Botëror (ang. World Economic Forum - WEF) dhe i publikon në Raportin Global të Konkurrueshmërisë. Për nevoja të këtij raporti është zbatuar një anketë me udhëheqësit ekzekutivë të 230 bizneseve, në një mostër të kompozuar dhe stratifikuar konform metodologjisë së WEF-it. Ekipi kërkimor ka llogaritur indekset e konkurrueshmërisë së ekonomisë së Kosovës duke u bazuar në të dhënat nga burimet sekondare që i ka përdorur edhe WEF-i.

Rekomandimet përqendrohen tek infrastruktura institucionale lidhur me politikat për zhvillim të kërkimeve dhe dijes në funksion të inovacioneve dhe rritjes së aftësisë konkurruese me theks të veçantë në institucionet qeveritare, akademike, institute, biznese, organizata financiare dhe fondet për zhvillim të aftësive konkurruese.

POZITA E EKONOMISË SË KOSOVËS LIDHUR ME AFTËSINË KONKURRUESE GLOBALE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Rritja e nivelit të aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës (shkurt konkurrueshmërisë) është një nga parakushtet qenësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës, deficiti kronik i të cilit krahas papunësisë ende të lartë, paraqesin dy nga problemet më të mëdha ekonomike të Kosovës. Kjo ndërlidhet edhe me kriteret e Kopenhagës sipas të cilave ndërtimi i një ekonomie të qëndrueshme dhe konkurrencte përbën një nga kërkesat kryesore për një ekonomi konvergjente të gatshme për integrim në BE. Andaj qëllimi i këtij Raporti studimor është të përmirësohet informacioni për institucionet qeveritare dhe kërkimore lidhur me nivelin e konkurrueshmërisë së politikave dhe cilësisë së institucioneve, krahasuar me vendet e tjera në rrafshin global dhe në atë rajonal. Me anë të këtij Raporti një informacion i tillë bëhet i disponueshëm për herë të parë për krijuesit e politikave dhe komunitetin kërkimor në Kosovë.

Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum (WEF) – publikon Raportin Global të Konkurrueshmërisë, në të cilin përfshihen 142 vende (2021). Deri tani Kosova nuk është përfshirë në këtë raport, dhe kjo krijon vështirësi për një vlerësim më kompleks të pozitës së Kosovës sa i përket cilësisë së politikave dhe institucioneve që determinojnë nivelin e produktivitetit, nivelin e produktivitetit të konkurrueshmërisë dhe përgjithësisht rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Treguesi sintetik (Indeksi i përgjithshëm) që pasqyron renditjen e 142 vendeve në Raportin e WEF-së bazohet në katër komponentë siç janë: mjedisi mbështetës, kapitali njerëzor, tregjet dhe ekosistemi i inovacionit, dhe 12 shtylla të cilat janë të përfshira në kuadër të secilit komponent. Konkurrueshmëria matet duke u bazuar në 103 indikatorë individualë dhe bazohet në të dhëna sekondare dhe anketën e opinionit ekzekutiv për biznese dhe përfshin gjithsej 142 shtete. Ky raport studimor është i pari i këtij lloji në Kosovë që mat konkurrueshmërinë e Kosovës duke u bazuar në metodologjinë e Forumit Ekonomik Botëror. Qëllimi i këtij raporti është të analizohet pozita konkurruese e Kosovës në botë dhe po ashtu në rajonin e Ballkanit Perëndimor duke u bazuar në indeksin e konkurrueshmërisë të vitit 2019.

Kosova renditet e 69-ta në botë sipas indeksit të përgjithshëm të konkurueshmërië, ku i pari prin Singapori. Në shtyllat në të cilat Kosova ka renditje më të lartë në këtë indeks janë: tregu i punës (14), përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit -TIK (34), ndërsa në shtyllat që Kosova renditet relativisht mirë janë: shëndeti (57), aftësitë dhe dinamizmi i biznesit (58), sistemi financiar dhe tregu (62). Në shtyllat që Kosova renditet me performancën më të ulët janë madhësia e tregut (129) dhe aftësia për inovacion (128). Po ashtu problematike dalin të jenë edhe sigurimi i bizneseve për të parashikuar kushtet e zhvillimit të ardhshëm, kapitali social, orientimi i qeverisë në të ardhmen dhe transparencja.

Në krahasim me shtetet e rajonit, Kosova ka performancë më të lartë në dy shtylla përdorimi: TIK-u dhe tregu i punës, ndërsa e dyta renditet në pesë shtylla: shëndeti, infrastruktura, institucionet, sistemi financiar dhe tregu i produkteve. Ashtu si në renditjen në nivel global, ashtu edhe atë rajonal Kosova renditet e fundit në shtyllën, aftësia për inovacion.

REKOMANDIMET

- Duke qenë se ky raport studimor pasqyron vetëm një informacion bazik lidhur me pozitën konkurruese ndërlidhur me faktorët që formësojnë mjedisin institucional dhe parakushtet ndikuese në produktivitet dhe rritje të qëndrueshme ekonomike në Programin Kombëtar të Kërkimeve dhe Inovacioneve, si dhe nga ministritë përkatëse, rekomandohet që të mbështeten studime më të thelluara për sektorë të caktuar të industrisë dhe të veprimtarive të tjera ekonomike duke përfshirë edhe shërbimet me vlerë të lartë shtuese. Në bazë të kësaj, duhet të fuqizohen politikat e bazuara në evidencë kërkimore lidhur me përcaktimin e prioritetëve të zhvillimit të vendit.
- Kosova duhet ta përmirësojë performancën e saj në indeksin e konkurrueshmërisë në nivel global dhe rajonal, përmes një analize të detajuar të indikatorëve të shtyllave dhe nënshtyllave përmes një plani gjithëpërfshirës dhe integritit të strategjive në fuqi dhe forcimit të mekanizmave për të siguruar një performancë më të qëndrueshme.
- Mbështetja sistematike dhe urgjente rekomandohet në aspektin e burimeve dhe vëllimit të financimit për Ekosistemin e inovacionit në Kosovë, përkatësisht në kërkime zhvillimore që rezultojnë me inovacion. Kjo kërkon aftësimin dhe zhvillimin e institucioneve mbështetëse qeveritare dhe atyre kërkimore dhe bashkërenditje më të mirë në katërkëndshin: institucionet qeveritare, institucionet kërkimore, sektori i bizneseve dhe shoqëria civile. Është e nevojshme të bëhen investime më të mëdha në kërkim dhe zhvillim duke iu afruar mesatares se rajonit në një periudhë afatmesme. Kjo përfshin edhe krijimin e kushteve për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet institucioneve akademike dhe industrisë dhe aplikimin e stimujve për kompanitë që të investojnë në inovacion, duke u ofruar, midis të tjerash, edhe stimuj tatimorë, mbrojtje të pronësisë intelektuale dhe duke ndjekur parimet e shkencës së hapur.
- Investimet në kapitalin njerëzor nënkuptojnë një sistem edukimi dhe arsimimi në një nivel shumë më të lartë duke përfshirë ngritje të kapaciteteve të institucioneve të arsimit në të gjitha nivelet, përfshirë edhe arsimin profesional, në pajtim me revolucionin e katërt industrial IR (Industria 4.0).

1. VËREJTJET HYRËSE DHE OBJEKTIVAT¹

Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum – WEF) – publikon Raportin Global të Konkurrueshmërisë, në të cilin përfshihen 142 vende (2021). Deri tani Kosova nuk është përfshirë në këtë raport, dhe kjo krijon vështirësi për një vlerësim më kompleks të pozitës së Kosovës sa i përket cilësisë së politikave dhe institucioneve që determinojnë nivelin e produktivitetit, si një nga faktorët kyç të konkurrueshmërisë dhe përgjithësisht rritjes së qëndrueshme ekonomike. Rritja e nivelit të konkurrueshmërisë është një nga parakushtet qenësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës, deficitin kronik i të cilit krahas papunësisë ende të lartë, paraqesin dy nga problemet më të mëdha ekonomike të Kosovës. Kjo ndërlidhet edhe me kriteret e Kopenhagës sipas të cilave ndërtimi i një ekonomie të qëndrueshme dhe konkurrense përbën një nga kërkesat kryesore për një ekonomi konvergjente të gatshme për integrim në BE.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) në programin e kërkimeve për 2022-2023 ka paraparë që të bëhet një studim, i cili, duke ndjekur metodologjinë e njëjtte me raportin e WEF-it të Davosit, do të pasqyrojë nivelin e konkurrueshmërisë institucionale dhe të politikave dhe do të mundësonte një krahasim në rrafshin global dhe rajonal. Andaj qëllimi i këtij Raporti studimor është të përmirësohet informacioni për institucionet qeveritare dhe kërkimore lidhur me nivelin e konkurrueshmërisë së politikave dhe cilësisë së institucioneve, krahasuar me vendet e tjera në rrafshin global dhe në atë rajonal. Me anë të këtij Raporti, një informacion i tillë bëhet i disponueshëm për herë të parë për krijuesit e politikave dhe komunitetin kërkimor në Kosovë.

Niveli i konkurrueshmërisë nëpërmjet Raportit të WEF-it shprehet me Indeksin global të konkurrencës. Ky indeks është një vlerësim gjithëpërfshirës dhe shërben si një instrument për krahasimin e vendeve dhe përcaktimin e çaqeve e standardeve (benchmarks) që duhet arritur nga vendet e caktuara.

Ndikimi i globalizimit dhe revolucionit IV industrial (Industria 4.0) ka sjellë ndryshime të thella në faktorët e konkurrencës dhe modelit biznesor. Siç thekson edhe njëri nga autorët dhe udhëheqësit e WEF-it, këto ndryshime “kanë krijuar mundësi të reja, por edhe çrregullime (disruption) dhe polarizime midis ekonomive por edhe shoqërive.” Duke u përgjigjur ndaj këtij konteksti, WEF-i e modifikoi këtë indeks duke e quajtur Indeksi Global i Konkurrueshmërisë 4.0 si një kompas orientues shumë i nevojshëm i ndërtuar në bazë të përvojës 40-vjeçare lidhur me krahasimet me shembujt më të mirë (benchmarks), lidhur me nxitësit afatgjatë të konkurrueshmërisë.²

Raporti i WEF-it, nëpërmjet këtij indeksi të përgjithshëm dhe indekseve për shtyllat prej të cilave ai përbëhet vlerëson aftësinë e vendeve të caktuara për të siguruar parakushtet për një prosperitet të tyre. Kjo natyrisht se varet nga niveli i produktivitetit dhe cilësia më të cilën

¹ Realizimi i këtij studimi dhe raporti është konceptuar dhe realizuar nga ekipi i projektit akad. Justina Shirok- Pula, akad. Besnik Krasniqi, prof. Muhamet Mustafa, dr. Alban Hashani, dr. Liridon Kryeziu dhe msc.Gent Beqiri.

² KLAUS SCHWAB Founder and Executive Chairman, World Economic Forum (2019)

përdoren burimet që vendet e caktuara i kanë në disponim. Nëpërmjet këtij Indeksi matet cilësia dhe efektiviteti i bashkësisë së institucioneve dhe politikave që influencojnë suksesin dhe nivelin e prosperitetit ekonomik në një horizont afatshkurtër dhe afatmesëm. Konsistente me këtë Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum) e definojnë aftësinë konkurruese si një "aftësi të ekonomisë së caktuar për të arritur normë të qëndrueshme të rritjes së lartë ekonomike të shprehur me produktin e brendshëm bruto për një banor (GDP per capita).³

Aspektet metodologjike janë përshkruar në detaj në kapitullin 2 dhe në aneks. Në kapitullin 3 ofrohet pasqyra e nivelit të konkurrueshmërisë së Kosovës në nivel global dhe krahasuar me vende të caktuara, si dhe nëpër shtyllat kyçe (komponentët) të konkurrueshmërisë, të cilat përmbledhen në indeksin e përgjithshëm. Duke u bazuar në gjetjet e indeksit të përgjithshëm të konkurrueshmërisë Kosova rangohet në vendin 68-të nga 142 vende (2019). Kjo gjithsesi nuk është tepër deprimuese për një vend që ka kaluar nëpër një zhvillim historik shumë specifik dhe tepër të vështirë, por nga ana tjetër jep sinjale të qarta për punën dhe përkushtimin që kërkohet në nivel institucional, biznesor dhe kërkimor e inovativ për ta përmirësuar pozitën ku ndodhemi tani, dhe me këtë edhe performancën e përgjithshme të ekonomisë së vendit.

³ World Economic Forum (WEF) (2019). Methodology and Computation of the Global Competitiveness Index 2017–2018. World Economic Forum.
Linku: <https://www3.weforum.org/docs/GCR2017-2018/04Backmatter/TheGlobalCompetitivenessReport2-017%E2%80%932018AppendixA.pdf>

2. VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME PËR METODOLOGJINË⁴

Forumi Ekonomik Botëror i Davosit e përkufizon aftësinë konkurruese (konkurrueshmërinë) si rezultat që esencialisht del nga veprimi i një grupi institucionesh, politikave dhe faktorëve që përcaktojnë nivelin e produktivitetit të një vendi. Ndërsa, produktivitetin e definojnë si nivelin e zhvillimit dhe prosperitetit që mund të arrihet nga një ekonomi.⁵ Forumi Ekonomik Botëror (WEF) mat nivelin e konkurrencës së një ekonomie bazuar në 4 komponentë që përbëhen nga 12 shtylla dhe një sërë nënshtyllash dhe indikatorësh. Kjo mbështetet nga një kuadër metodologjik që përfshin tregues përkatës për secilën shtyllë, nën-shtyllë të ndërtuar në bazë të burimeve sekondare që publikohen nga agjenci dhe organizata ndërkombëtare sipas një metodologjie standarde dhe të sprovuar me vite duke e plotësuar këtë edhe me anketën e udhëheqësve ekzekutivë të bizneseve – sektorit privat në secilin vend të përfshirë.

Të katër komponentët e kornizës së indeksit të konkurrencës globale ndahen në 12 shtylla, si vijon:

- Komponenti i parë përfshin shtyllat e mjedisit mbështetës: institucionet (shtylla 1), infrastrukturën (shtylla 2), përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK (shtylla 3)), stabilitetin makroekonomik (shtylla 4).
- Komponenti i dytë përfshin kapitalin njerëzor dhe përmban dy shtylla: Shëndetin (shtylla 5) dhe Aftësitë (shtylla 6).
- Komponenti i tretë – tregu, përfshin tregun e produktit (shtylla 7), tregun e punës (shtylla 8), sistemin financiar (shtylla 9), madhësinë e tregut (shtylla 10).
- Komponenti i katërt përfshin shtyllat e ekosistemit të inovacionit përkatësisht dinamizmin e biznesit (shtylla 11) dhe aftësinë e inovacionit (shtylla 12).


Në pjesën e parë të shtojcës janë të shpjguara shkurtimisht të gjitha shtyllat, ndërsa në pjesën e dytë të shtojcës shpjgohen indikatorët dhe mënyrat se si janë matur këta indikatorë në kuadër të shtyllave dhe nënshtyllave.

Duke ndjekur me rigorozitet metodologjinë që përdor WEF-i, ekipi kërkimor ka llogaritur indekset e konkurrueshmërisë së ekonomisë së Kosovës duke u bazuar në të dhënat e burimet sekondare nga burimet që i ka përdorur edhe WEF-i dhe gjithashtu për nevoja të këtij raporti është zbatuar një anketë me udhëheqës të 230 bizneseve, në një mostër të kompozuar dhe stratifikuar në pajtim me metodologjinë e WEF-it. Anketa është realizuar me pyetësonin që është standard për të gjitha vendet që përfshihen në Raportin e WEF-it. Vlen të theksohet se shumica e vendeve të përfshira në Raportin e WEF-it kanë anketuar rreth 100 udhëheqës ekzekutivë të bizneseve. Ne kemi marrë një numër më të madh për të siguruar një përfshirje sa më cilësore duke marrë parasysh se ky është raporti i parë i këtij lloji për Kosovën. Karakteristikat kryesore të mostrës janë dhënë më poshtë (Figura 1 dhe 2).

⁴ Sqarimet metodologjike janë bazuar në tekstin e Raportit të Forumit Ekonomik Botëror.

⁵ World Economic Forum (WEF) (2019). Methodology and Computation of the Global Competitiveness Index 2017–2018. Linku: <https://www3.weforum.org/docs/GCR2017-2018/04Backmatter/TheGlobalCompetitivenessReport2017-%E2%80%932018AppendixA.pdf>


Figura 1: Sektori dhe madhësia e biznesit



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

Në mostrën e përfshirë, shumica e bizneseve janë në pronësi të sektorit privat-vendës me 82.4 për qind, pasuar me 13.5 për qind që janë në pronësi të huaj dhe 4.1 për qind në pronësi të shtetit. Sa i përket gjinisë, shumica absolute e pronarëve janë burra me gjithsej 94.4 për qind, ndërsa 6.6 për qind janë gra. Rreth 43 për qind janë ndërmarrje të vogla, 27 për qind ndërmarrje të mesme dhe 21.2 për qind janë mikrondërmarrje, ndërsa ndërmarrje të mëdha 8.5 për qind. Sa i përket sektorëve, 60.7 për qind e bizneseve janë nga sektori i shërbimeve, pasuar nga industria e prodhimit me 26.6 për qind dhe industria joprodhuese me 11.4 për qind.

Figura 2: Pronësia dhe gjinia e pronarit



Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

3. POZITA E KOSOVËS NË KONKURRUESHMËRINË GLOBALE

Në pjesën vijuese do të paraqiten gjetjet sa i përket nivelit të konkurrueshmërisë së Kosovës, gjetje të cilat janë bazuar në indikatorët e definuar në metodologjinë e indeksit të konkurrencës globale të Forumit Ekonomik Botëror. Po ashtu, për të pasur një pasqyrë më të qartë të nivelit të konkurrueshmërisë së Kosovës, në pjesën e dytë është bërë një krahasim me shtetet e rajonit për të nxjerrë një informacion në kontekstin rajonal e që është i rëndësishëm për shumë procese që ndërlidhen sidomos me procesin e Berlinit.

Siç u tha edhe në hyrje të këtij Raporti bazuar në indeksin e përgjithshëm, Kosova del të ketë një arritje prej 68 për qind nga 100 potenciale. Për të pasur një pasqyrë më të afërt po japim një pasqyrë lidhur me vendin e Kosovës sa i përket indeksit të përgjithshëm me 10 vende karakteristike. Në shtojcën 1 të këtij raporti është tabela që përfshin renditjen e të gjitha vendeve, duke përfshirë të gjitha shtyllat dhe nënshtyllat që e përbëjnë indeksin global.

Tabela 1: Renditja e përgjithshme

Shteti ^a	Indeksi i përgjithshëm	Renditja
Singapori	84.59	1
Hong Kongu	82.63	2
Zvicra	82.17	3
<i>Slllovenia</i>	<i>70.41</i>	<i>30</i>
<i>Bullgaria</i>	<i>64.61</i>	<i>47</i>
<i>Mali i Zi</i>	<i>61.98</i>	<i>59</i>
<i>Kroacia</i>	<i>60.76</i>	<i>63</i>
Kosova^b	59.86	68
Serbia	59.95	67
Maqedonia e Veriut	56.69	84
Shqipëria	56.59	85
Rep. Demokratike e Kongos	34.88	140
Çadi	34.81	141
Jemeni	32.92	142

Burimi: a) Indeksi i Konkurrueshmërisë (WEF, 2019); b) Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

Rezultati për institucionet shprehet në nivelin e konkurrueshmërisë në shtyllën fushën e caktuar nga 0 në 100 (maksimal). Shtetet që arrijnë më shumë se 90 pikë, vlerësohet se janë në kufirin e lartë, ndërsa më shumë se 80 pikë deri në mbi 90 nënkupton se shteti i caktuar është afër

kufirit të lartë. Analiza e konkurrueshmërisë e Kosovës në nivel global, sikurse edhe për vendet e tjera, është nxjerrë duke u bazuar në katër komponentë kryesorë që e formësojnë këtë indeks, siç janë: mjedisi mbështetës, kapitali njerëzor, tregu, ekosistemi i inovacionit. Krahasimi do të bëhet duke u bazuar në rezultatet e gjetjeve nga raporti i indeksit të konkurrueshmërisë të Forumit Ekonomik Botëror të vitit 2019, pasi ky është raporti i fundit që ka prezantuar renditjen me indeksin e përgjithshëm dhe atë sipas shtyllave që e përbëjnë atë për 142 shtete e përfshira.⁶ Raporti i publikuar për vitin 2021 i është kushtuar në mënyrë specifike ndikimit të epidemisë Covid dhe nuk ka përfshirë renditjen e zakonshme të vendeve. Në vazhdim po e japim pozitën përkatësisht renditjen e Kosovës sipas komponentëve dhe shtyllave përbërëse.

3.1. MJEDISI MBËSHTETËS

Shtyllat që e definojnë komponentën e mjedisit mbështetës, sipas metodologjisë së Forumit Ekonomik Botëror janë: institucionet, infrastruktura, përdorimi i TIK-ut dhe stabiliteti makro-ekonomik (Tabela 2). Në këtë pjesë do të bëhet analizë krahasimore duke u bazuar në indeksin e konkurrueshmërisë së shteteve që kanë performancë më të lartë, ato që kanë performancën me të ulët në indeksim dhe gjithashtu pozitën e Kosovës me shtetet që kanë performancë të ngjashme.

Shtylla e institucioneve pasqyron se sa janë institucionet e favorshme për të krijuar një mjedis të favorshëm për bizneset dhe ndërmarrësit. Kjo shtyllë përfshin disa prej faktorëve mbështetës përkatësisht ndikues siç janë: sundimi i ligjit, të drejtat e pronësisë, efektshmëria e qeverisjes dhe niveli i korrupsionit. Të gjithë këta faktorë janë të rëndësishëm dhe determinojnë nivelin e cilësisë së institucioneve duke pasqyruar se deri në çfarë mase mjedisi i biznesit është i favorshëm, që rrjedhimisht ndikon në operimin e bizneseve, në investime, në inovacione etj.⁷ Në këtë shtyllë, Finlanda renditet e para në botë (81.2), Kosova renditet e 68-ta me 54.7 pikë, një pozitë më lart se Tailanda, ndërsa Venezuela renditet e fundit në botë me 25.7 pikë. Në kuadër të kësaj shtylle, siguria ka pikët më të larta dhe Kosova renditet e 68-ta, ndërsa në nënshtyllat e tjera, të cilat në renditje që mund të konsiderohet problematike dhe me performancë më të dobët, janë transparenca (39), orientimi i qeverisë në të ardhmen (40.2), kapitali social (45).

Shtylla e infrastrukturës përfshin indikatorët që janë të rëndësishëm për të krijuar një rritje dhe zhvillim ekonomik. Rrjedhimisht, kur infrastruktura nuk është e zhvilluar në nivelin e duhur, atëherë ndikon negativisht në operimin e bizneseve duke rritur kostot e operimit dhe të logjistikës, që ndikon negativisht në eficiencën e tyre.⁸ Ndër nënshtyllat e përfshira në infrastrukturë janë: sistemi i transportit, infrastruktura e energjisë, rrjetet e telekomunikacionit dhe elementet kryesore të infrastrukturës fizike. Kosova renditet në vendin e 74-t për dallim nga

⁶ Shënim: Në studimin e indeksit të konkurrueshmërisë janë përfshirë 141 shtete. Në tabelat më poshtë renditja e shteteve është bërë duke përfshirë edhe Kosovën, pra gjithsej 142 shtete.

⁷ Schwab, Klaus dhe Zahidi, Saadia (2020). How Countries are Performing on the Road to Recovery. The Global Competitiveness Report 2020, Special Edition, World Economic Forum (WEF).
Linku: <https://www.weforum.org/reports/the-global-competitiveness-report-2020>

⁸ Schwab, Klaus dhe Zahidi, Saadia (2020). How Countries are Performing on the Road to Recovery. The Global Competitiveness Report 2020, Special Edition, World Economic Forum (WEF).
Linku: <https://www.weforum.org/reports/the-global-competitiveness-report-2020>

Singapori i cili renditet si shteti me infrastrukturën më të zhvilluar në botë, dhe Angolën që renditet e fundit me infrastrukturën më të dobët në botë.

Tabela 2: Mjedisi mbështetës

	Performuesi më i mirë	Kosova	*	Performuesi më i keq
Institucionet 0-100	Finlanda	Kosova	Tailanda	Venezuela
Vlera	81.2	54.7	54.6	25.7
Rank	1	68	69	142
Infrastruktura 0-100	Singapori	Kosova	Bosnja dhe Hercegovina	Angola
Vlera	95.4	67.5	63.0	40.2
Rank	1	74	75	126
Adaptimi i TIK 0-100	Republika e Koresë	Kosova	Portugalia	Çadi
Vlera	92.8	71.4	71.2	10.8
Rank	1	34	35	142
Stabiliteti Makroekonomik 0-100	Multiple⁹	Kosova	Bangladesh	Venezuela
Vlera	100.0	73.3	72.8	0.0
Rank	1	95	96	142

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është faktor kritik për të rritur produktivitetin dhe krijuar një mjedis të favorshëm për të përmirësuar cilësinë e vendimeve dhe ulur koston e transaksioneve si dhe për të përmirësuar operacionet në kuadër të zinxhirit të vlerës e për komunikimin efektiv me partnerët dhe klientët¹⁰. Vlen të nënvizohet se kjo shtyllë merr parasysh indikatorët si qasja në internet me shpejtësi të lartë, penetrimi i telefonisë së celularëve dhe adoptimi i tregtisë elektronike, por nuk përfshin indikatorë siç janë aftësitë e fuqisë punëtore dhe sektorit privat në raport me ICT-në, dhe nivelin e digjitalizimit të sektorit privat¹¹. Në këtë shtyllë, prin Republika e Koresë në botë (92.8), ndërsa Kosova renditet e 34-ta me 71.4 pikë, një më lart se Portugalia e cila renditet e 35-ta dhe Çadi që renditet i fundit përkatësisht i 142-ti në botë.

Shtylla që pasqyron stabilitetin makroekonomik dhe qëndrueshmërinë e tij, është e rëndësishme për ndikimet me peshë në funksionimin e bizneseve, sidomos lidhur me planifikimet e bizneseve

⁹ Shënim: Multiple nënkupton se më shumë se një shtet ka arritur shifrën e 100 pikëve.

¹⁰ World Economic Forum (2020). The Future of Jobs Report 2020. World Economic Forum. Linku: <https://www.weforum.org/reports/the-future-of-jobs-report-2020>

¹¹ Shënim: për më shumë referoju tabelës A1 në shtojcë dhe indikatorët që matin Përdorimin e ICT-së.

për investime, inovacion, duke përfshirë vlerësimet për inflacionin dhe qëndrueshmërinë e valutës së vendit, përfshirë mjedisin rregullues, përkatësisht kushtet për siguri në parashikimet për kushtet e zhvillimit të biznesit¹². Në këtë shtyllë Kosova renditet e 95-ta në botë, një vend më mirë se Bangladeshi, dhe në fund renditet Venezuela. Ky indeks jep një indikacion se Kosova ka nevojë të krijojë një stabilitet makroekonomik që është faktor motivues për bizneset për të investuar dhe ulur pasigurinë që buron nga institucionet.

3.2. KAPITALI NJERËZOR

Komponenti i kapitalit njerëzor mat dy shtylla, shëndetin dhe aftësitë e popullatës. Shtylla e shëndetit është matur duke u bazuar në një indikator, atë të jetëgjatësisë së shëndetshme. Kosova në këtë shtyllë renditet e 57-ta, një vend para Sllovakisë, ndërsa Lesotho është shteti që renditet i fundit në botë me performancën më të ulët krahasuar me shtetet e tjera¹³. Shtylla e aftësive mat aftësitë e fuqisë punëtore aktuale dhe, aftësitë e fuqisë punëtore të ardhshme. Në këtë shtyllë, Zvicra (86.7), renditet e para në botë, ndërsa Kosova renditet si e 59-ta, kurse Çadi ka performancën më të ulët. Në të gjitha nënshtyllat, Kosova ka një mesatare më pak se 70 pikë, gjë që reflekton dhe në pikët në renditjen në nivel global.

Tabela 3: Kapitali njerëzor

	Performuesi më i mirë	Kosova	*	Performuesi më i keq
Shëndeti 0-100	Multiple	Kosova	Sllovakia	Lesotho
Vlera	100.0	82.3	82.3	21.7
Rank	1	57	58	142
Aftësitë 0-100	Zvicra	Kosova	Jordania	Çadi
Vlera	86.7	67.4	67.2	29.0
Rank	1	58	59	142

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

3.3. TREGJET

Komponenti “tregjet” vlerësohet duke u bazuar në katër shtylla: tregu i produkteve, tregu i punës, sistemi financiar dhe madhësia e tregut. Me përjashtim të shtyllës së fundit (madhësia e tregut), në tri shtyllat e tjera, Kosova renditet me performancë të krahasueshme edhe me shtetet e Bashkimit Evropian, si Bullgarinë, Gjermaninë, dhe Kroacinë.

¹² World Economic Forum (2019). The Global Competitiveness Report 2019. World Economic Forum. Linku: https://www3.weforum.org/docs/WEF_TheGlobalCompetitivenessReport2019.pdf

¹³ Shënim: Vlen të theksohet se shtylla e shëndetit nuk e mat sistemin e shëndetësisë në vend, kualitetin e shërbimeve të ofruara në vend, por gjendjen shëndetësore të popullit bazuar po ashtu në jetëgjatësi.

Tabela 4: Tregjet

	Performuesi më i mirë	Kosova	*	Performuesi më i keq
Tregu i Produkteve 0–100	Hong Kong SAR	Kosova	Bullgaria	Çadi
Vlera	81.6	55.8	55.7	35.4
Rank	1	62	64	142
Tregu i punës 0-100	Singapori	Kosova	Gjermania	Jemen
Vlera	81.2	73.1	72.8	40.9
Rank	1	14	15	142
Sistemi Financiar 0-100	Hong Kong SAR	Kosova	Kroacia	Jemen
Vlera	91.4	62.5	61.9	29.0
Rank	1	62	64	142
Madhësia e tregut 0-100	Kina	Kosova	Ruanda	Seychelles
Vlera	100.0	35.5	35.1	17.1
Rank	1	129	130	142

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

Në shtyllat tregu i produkteve dhe sistemi financiar, Hong Kongu prin në botë si shteti me performancën më të mirë. Shtylla tregu i punës mat indikatorët që ndërlidhen me konkurrencën e brendshme dhe hapjen e këtij tregu, ndërsa sistemi financiar mat indikatorët që ndërlidhet me intensitetin e financimit dhe stabilitetin e tij. Kosova renditet më lart se dy shtetet e Bashkimit Evropian, Bullgaria dhe Kroacia, sa u përket tregut të produkteve dhe sistemit financiar. Shtylla tregu i punës mat indikatorët, si fleksibiliteti dhe meritokracia dhe stimulimi, duke u bazuar kryesisht në perceptimin e firmës. Në këtë shtyllë, Singapori është në vendin e parë, ndërsa Kosova renditet si e 14-ta në botë një vend më lart se Gjermania. Për fund, në shtyllën madhësia e tregut, Kosova renditet e 129-ta në botë. Nënkuptohej se në këtë shtyllë Kina është e para me tregun e saj nacional, bazuar edhe në numrin e banorëve.

3.4. EKOSISTEMI I INOVACIONIT¹⁴

Krahasuar me shtyllat e tjera, renditjen më problematike Kosova e ka tek “aftësia për inovacion duke zënë vendin e 128-të në botë. Në këtë renditje e para prin Gjermania, ndërsa në vendin e fundit është Kongo. Shtylla aftësia për inovacion përbëhet prej tri nënshtyllave në të cilat renditjen më të ulët Kosova e shënon te kërkimi shkencor dhe zhvillimi ku Kosova renditet në vendin e 138-të me vetëm katër vende më keq. Ngjashëm jemi edhe te komercializimi i

¹⁴ Ekosistemi i inovacioneve (Innovation ecosystems) përkufizohet si struktura të formuara për ndërveprim midis aktorëve të cilët janë të thirrur (përkushtuar) me qëllime që të ndjekin zhvillimin e teknologjisë dhe inovacioneve (M. Kumorovsky, VUV, Bursels 2019).

kërkimeve për zhvillim dhe inovacione ku jemi në vendin e 132-të dhe diçka më mirë te ndërveprimi dhe diversiteti ku Kosova renditet e 84-ta në botë. Kjo duhet të jetë një sinjal alarmues për institucionet qeverisëse, institucionet kërkimore dhe universitare dhe tërë komunitetin kërkimor. Siç del edhe nga analiza dhe studime të tjera, kjo është pasojë e problemeve shqetësuese lidhur me nivelin e financimit dhe të sistemit shumë modest mbështetës për kërkime zhvillimore dhe inovacionet e zbatimin e tyre¹⁵.

Tabela 5: Ekosistemi i inovacionit

	Performuesi më i mirë	Kosova	*	Performuesi më i keq
Dinamizmi i biznesit 0-100	SHBA	Kosova	Gjeorgjia	Haiti
Vlera	84.2	62.3	62.2	14.1
Rank	1	58	59	142
Aftësia për inovacion 0-100	Gjermania	Kosova	Mauritania	Rep. Demokratike e Kongos
Vlera	86.8	26.6	26.3	18.0
Rank	1	128	129	142

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

Në shtyllën e dinamizmit, e cila bazohet në dy indikatorë kryesorë siç janë: kërkesat administrative dhe kultura ndërmarrëse, Kosova renditet e 58-ta, një vend më lartë se Gjeorgjia, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) renditet e para, kurse Haiti renditet i fundit.

¹⁵ Zhvillimi i kërkimeve dhe inovacionit në Kosovë (Raport studimor, Instituti Riinvest 2023)

4. KONKURRUESHMËRIA E KOSOVËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Pasqyrimi i pozitës lidhur me aftësinë konkurruese të Kosovës në kontekstin e rajonit të Ballkanit Perëndimor është veçanërisht e rëndësishme kur dihet niveli i këmbimit të mallrave dhe shërbimeve me gjashtë vendet fqinje, por edhe lidhur me ndikimet që mund të kenë nismat e ndryshme për bashkëpunim rajonal lidhur me Tregun e përbashkët rajonal, Procesin e Berlinit, por gjithashtu edhe iniciativën për “Ballkanin e hapur” e cila, ndonëse më e heshtur, kohëve të fundit mbetet ende e gjallë. Në përgjithësi, duke u bazuar në shtyllat e indeksit të konkurrueshmërisë e pasqyruar më lart, Kosova është e para në rajon në dy shtylla: përdorimi i TIK-ut (Teknologjia e informacionit dhe komunikimit) dhe tregu i punës, ndërsa në shtyllat siç janë: shëndeti, infrastruktura, institucionet, sistemi financiar dhe tregu i produkteve është e dyta në rajon. Për shkaqet e cekura më lart në shtyllën aftësia për inovacion, Kosova ka performancën më të dobët në krahasim me shtetet e rajonit. Më në hollësi shih tabelën në shtojcën 1. Tabela 10.

4.1. MJEDISI MBËSHTETËS

Në shtyllën përdorimi i ICT-së, Kosova prin në rajon me 71.4 pikë, pasuar nga Maqedonia e Veriut (57.6) si shteti i dytë me performancë më të lartë. Shteti që ka pikët më të ulëta në rajon, është Shqipëria me 52.9, edhe pse dallimi me shtetet tjera si Bosnja dhe Hercegovina, Serbia është shumë e vogël. Në shtyllën e institucioneve Mali i Zi prin në rajon (50.7) ndërsa Kosova është e dyta në këtë shtyllë me 54.7 pikë. Shteti me performancën më të dobët në rajon është Bosnja dhe Hercegovina me 44.4 pikë. Në shtyllën e infrastrukturës, Serbia është shteti me performancën më të lartë (73.8), ndërsa Shqipëria është shteti i fundit në rajon me gjithsej 57.7 pikë. Shtetet e tjera, si Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi kanë një performancë të përafërt sa i përket kësaj shtylle. Për fund, në shtyllën e Stabilitetit Makroekonomik vërejmë se të gjitha shtetet kanë më shumë se 70 pikë, ku prijnë Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia, ndërsa shteti me pikët më të ulëta është Shqipëria.

Tabela 6: Mjedisi mbështetës

Shtetet/Indikatorët	Institucionet	Infrastruktura	Përdorimi i ICT	Stabiliteti Makroekonomik
Kosova	54.7	67.5	71.4	73.3
Shqipëria	51.9	57.7	52.9	70
Bosnja dhe Hercegovina	44.4	63	51.6	75
Maqedonia e Veriut	50.7	66.9	57.6	74.8
Mali i Zi	57.3	63.6	62.9	70
Serbia	52.5	73.8	52.6	75

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

4.2. KAPITALI NJERËZOR

Në komponentin e kapitalit njerëzor Kosova është e dyta në shtyllën e shëndetit, ku prin Shqipëria (85.9) ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi kanë performancë të përafërt. Shteti me performancën më të ulët në rajon në shtyllën e shëndetit është Serbia. Në shtyllën e aftësive ka dallim të vogël në mes të shteteve ku prin Shqipëria pasuar nga Mali i Zi, Serbia dhe Kosova. Shtetet me performancën më të ulët në këtë shtyllë janë Maqedonia e Veriut dhe Bosnja e Hercegovina.

Tabela 7: Kapitali njerëzor

Shtetet/Indikatorët	Shëndeti	Aftësitë
Kosova	82.3	67.4
Shqipëria	85.9	69
Bosnja dhe Hercegovina	80.3	60
Maqedonia e Veriut	81.3	59.8
Mali i Zi	81.2	68.7
Serbia	79	68.2

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

4.3. TREGJET

Në komponentin *tregjet* Kosova ka performancë të mirë në indeksim krahasuar me shtetet e rajonit. Në shtyllën e tregut të punës Kosova prin në rajon me 73.1 pikë, pasuar nga Mali i Zi (67.7), ndërsa pikët më të ulëta merr Bosnja dhe Hercegovina (53.3). Dy shtyllat e tjera ku Kosova është e dyta, janë Tregu i Produkteve (55.8) dhe Sistemi Financiar (62.5). Në shtyllën *madhësia e tregut* Kosova është renditur e parafundit në rajon, gjë që nënkupton se Kosova ka tregun më të vogël ngjashëm me Maqedoninë e Veriut, ndërkaq Serbia këtu rangohet e para. Në këtë kontekst vlen të nënvizohet se sipas këtij indikator (40 në mesatare), del se madhësia e tregut është problematik për të gjitha vendet.

Tabela 8: Tregjet

Shtetet/Indikatorët	Tregu i produkteve	Tregu i punës	Sistemi financiar	Madhësia e tregut
Kosova	55.8	73.1	62.5	35.5
Shqipëria	54.4	65.3	53.3	39.6
Bosnja dhe Hercegovina	49.6	53.3	57.9	42.3
Maqedonia e Veriut	48.6	58.3	57.3	39.7
Mali i Zi	59.4	67.7	68	28.8
Serbia	54.6	62.1	57.4	51.8

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

4.4. EKOSISTEMI I INOVACIONIT

Në tabelën 9 vërejmë se asnjëri prej shteteve të rajonit të Ballkanit nuk ka arritur të këtë pikë të larta në shtyllën *Aftësia për Inovacion*. Kosova (26.6) renditet e fundit në rajon, ku prin Serbia me (40.2), pasuar nga Mali i Zi (38.3). Kjo nënkupton se edhe me gjithë dallimet, të gjitha vendet e rajonit mbeten dukshëm mbrapa në *Hulumtim dhe Inovacion* krahasuar me shtetet e Evropës. Në shtyllën *dinamizmi i biznesit*, Mali i Zi (64) prin në rajon, pasuar nga Serbia (63.1) dhe Kosova (62.3), ndërsa Bosnja dhe Hercegovina renditet e fundit në rajon (51.1). Në këtë shtyllë vërejmë se në përgjithësi të gjitha shtetet e rajonit kanë një mesatare të ulët në indeksin e konkurrueshmërisë. Vlen të theksohet se kjo shtyllë matet duke u bazuar nga perceptimet e bizneseve.

Tabela 9: Ekosistemi i inovacionit

Shtetet/Indikatorët	Dinamizmi i biznesit	Aftësia për inovacion
Kosova	62.3	26.6
Shqipëria	61.8	29.8
Bosnja dhe Hercegovina	51.1	28.4
Maqedonia e Veriut	61.2	31.8
Mali i Zi	64	38.3
Serbia	63.1	40.2

Burimi: Kalkulimet e autorëve bazuar në të dhënat e anketës.

Si përmbledhje vlen të konstatohet se megjithëse Kosova dhe vendet e rajonit kanë arritur rezultate të larta në disa shtylla, të gjitha këto vende ngecin për sa u përket rezultateve të pritura për të arritur kufirin e lartë të konkurrueshmërisë. Gjendja aktuale në të gjitha shtyllat, si për Kosovën ashtu edhe për shtetet e rajonit tregon që për të arritur nivelin e konkurrueshmërisë me shtetet e avancuara nevojitet përmirësim në të gjitha shtyllat njëkohësisht. Kosova është e para në dy fusha siç janë: përdorimi i TIK-ut dhe tregu i punës dhe e dyta në pesë shtylla. Kosova është e treta dhe e katërta në katër shtylla dhe e fundit vetëm në një shtyllë, atë të aftësisë për inovacion. Por, me gjithë faktin që Kosova është e para në dy dhe e dyta në pesë shtylla, kjo nuk nënkupton që ajo t'i ketë zgjidhur problemet e pozitës së konkurrueshmërisë me shtetet e rajonit në aspektin e zhvillimit socio-ekonomik dhe konkurrueshmërisë të sektorit privat, sidomos kur është fjala për kërkime zhvillimore dhe inovacionet. Andaj, është e nevojshme që të përmirësohet performanca e të gjitha shtyllave njëkohësisht, në mënyrë që Kosova të jetë më konkurruese krahasuar me shtetet e rajonit dhe të ketë një pozicion më konkurrues me shtetet e Bashkimit Evropian.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: KONKURRUESHMËRIA E KOSOVËS DHE KRAHASIMI RAJONAL

Tabela 10: Konkurrueshmëria e Kosovës

	KOS	KOS	Performuesi me i mirë
	Vlera	Rangimi	
Shtylla 1: Institucionet 0-100	54.7	68	Finlanda
Siguria 0–100	82.7	42	Finlanda
1.01 Krimi i organizuar 1–7 (më e mira)	62.7	63	Finlanda
1.02 Shkalla e vrasjeve për 100,000 popullatës.	97.6	44	Shumëfishtë
1.03 Incidenca e terrorizmit 0 (shumë e lartë) -100 (pa incidencë)	100.0	1	Shumëfishtë
1.04 1.04 Besueshmëria në shërbimet e policisë 1–7 (më e mira)	70.5	37	Finlanda
Kapitali social 0–100	45.0	118	Zelanda e re
1.05 Kapitali social 0–100 (më e mira)	45.0	118	Zelanda e re
Kontrollet dhe balancat 0–100	54.3	47	Finlanda
1.06 Transparenca buxhetore 0–100 (më e mira)	50.0	65	Shumëfishtë
1.07 Pavarësia e gjyqësorit 1–7 (më e mira)	47.8	72	Finlanda
1.08 Eficienca e kuadrit ligjor në rregullore sfiduese 1–7 (më e mira)	49.1	43	Finlanda
8.02 Praktikat e punësimit dhe e largimit nga puna

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, deri në çfarë mase rregulloret mundësojnë punësimin dhe shkarkimin fleksibël të punëtorëve?” 1 = aspak nuk mundësojnë; 7 = në një masë të madhe | 2018–2019 mesatarja e ponderuar ose periudha më e fundit e disponueshme.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinionit Ekzekutiv (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

8.03 Bashkëpunimi në marrëdhëniet punëmarrës-punëdhënës

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, si i karakterizoni marrëdhëniet punëmarrës-punëdhënës?” 1 = përgjithësisht konfrontuese; 7 = përgjithësisht bashkëpunuese (2018–2019 mesatare e ponderuar ose periudha më e fundit e disponueshme).

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinionit Ekzekutiv (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

8.04 Fleksibiliteti i përcaktimit të pagës

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, në përgjithësi, si përcaktohen pagat?” 1 = nga një proces i centralizuar negocimi; 7 = nga çdo kompani individuale (Mesatarja e ponderuar 2018–2019 ose periudha më e fundit në dispozicion).

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinionit Ekzekutiv (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

8.05 Politikat aktive të tregut të punës

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, deri në çfarë mase politikat e tregut të punës i ndihmojnë të papunësuarit të rikualifikohen dhe të gjejnë punësim të ri (duke përfshirë përputhjen e aftësive, rikualifikimin, etj.)?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe. (2018 – 2019 mesatarja e ponderuar ose periudha më e fundit e disponueshme).

³⁴ Shënim: Vlerësimi është bërë duke u bazuar në Bankën Botërore.
Linku: <https://www.worldbank.org/en/research/employing-workers/data/redundancy-cost>

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

8.06 Të drejtat e punëtorëve

Pikët të përshtatura nga Indeksi i të Drejtave Globale i ITUC, i cili mat nivelin e mbrojtjes së standardeve bazë ndërkombëtare të punës. Shkalla e këtij treguesi varion nga 0 (pa mbrojtje) deri në 100 (mbrojtje e lartë) | 2019.

Dimensionet e mbrojtjes së punës përfshijnë të drejtat civile, të drejtën për të negociuar në mënyrë kolektive, e drejta për grevë, e drejta për bashkim të lirë dhe qasje në të drejtat e procesit të rregullt ligjor. Treguesi nuk merr parasysh rregullat e largimit nga puna. Ndër vendet e vlerësuara si “D5” ne dallojnë vendet ku punëtorët “nuk kanë qasje në të drejtat e tyre” (Greqia, Hong Kongu, Kuvajti, Katari, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe) dhe vendet që po përjetojnë “dobësim të institucionit” (Afganistani, Libia) ose vrasjet (Guatemala). Ne përcaktojmë një pikë 10 për rastin e parë dhe 3 pikë për të fundit. Më shumë detaje rreth metodologjisë së Indeksit të të Drejtave Globale mund të gjendet në <https://survey.ituc-csi.org/ITUC-Global-Rights-Index.html>.

Burimi: Llogaritjet e Forumit Ekonomik Botëror bazuar në Konfederatat Ndërkombëtare të Sindikatave, Indeksi Global i të Drejtave 2019 (<https://www.ituc-csi.org/rights-index-2019>)

8.07 Lehtësia e punësimit të fuqisë punëtore të huaj

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, sa kufizuese janë rregulloret që kanë të bëjnë me marrjen në punë të të huajve?” 1 = shumë kufizuese; 7 = aspak kufizuese (2018 – 2019 mesatarja e ponderuar ose periudha më e fundit e disponueshme).

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

8.08 Lëvizshmëria e brendshme e forcës punëtore

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, deri në çfarë mase njerëzit lëvizin në pjesë të tjera të vendit për arsye profesionale?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe (Mesatarja e ponderuar 2018–2019 ose periudha më e fundit e disponueshme).

Ky tregues nuk vlen për ekonomitë e identifikuar si qytet shtetet: Bahreini, Brunei Darussalam, Hong Kong SAR, Kuvajt, Malta, Katari dhe Singapori.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

8.09 Mbështetja në menaxhimin profesional

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj kush mban pozita të larta drejtuese në kompani?” 1 = zakonisht të afërmit ose miqtë pa marrë parasysh meritat; 7 = kryesisht menaxherë profesionistë të zgjedhur për shkak të meritave dhe kualifikimeve. Mesatarja e ponderuar 2018–2019 ose periudha më e fundit e disponueshme.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinionit Ekzekutiv (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

8.10 Paga dhe produktiviteti

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, deri në çfarë mase është e lidhur paga me produktivitetin e punonjësve?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe. 2018–2019 mesatarja e ponderuar ose periudha e fundit në dispozicion.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinionit Ekzekutiv (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

8.11 Raporti i pagave në mes të punëtorëve femra ndaj punëtorëve meshkuj

Ilustron raportin e përqindjes së grave të moshës 15–64 vjeç që marrin pjesë në fuqinë punëtore si punëtore me pagë dhe me rrogë ndaj përqindjes së meshkujve të moshës 15–64 vjeç që marrin pjesë në fuqinë punëtore si punëtorë me pagë dhe me rrogë (2018 ose periudha e fundit në dispozicion).

Punëtorët (të punësuarit) me rrogë dhe paga janë ata punëtorë që mbajnë llojin e punëve të përcaktuara si "punësim me pagesë", ku të punësuarit mbajnë kontrata (me shkrim ose me gojë) që u jep atyre një kompensim bazë, e që nuk është i varur drejtpërdrejt nga të ardhurat e njësisë për të cilën ata punojnë.

Burimi: Llogaritja e Forumit Ekonomik Botëror bazuar në Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ONP), ILOSTAT (<https://ilostat.ilo.org/>), aksesuar më 22 prill 2019).

8.12 Norma e tatimit në punë

Taksa e punës dhe kontributet janë shumat e taksave (në çdo nivel - federal, shtetëror ose lokal) dhe kontributet e detyrueshme në punën e paguar nga biznesi, e shprehur si përqindje nga fitimet komerciale (2018).

Kjo masë përfshin kontributet e paguara me mandat të qeverisë nga punëdhënësi në një fond pensioni privat të detyrueshëm apo në fondin e sigurimit të punëtorëve.

Më shumë detaje rreth këtij treguesi mund të gjenden në:

<http://www.doingbusiness.org/Methodology/Paying-Taxes>.

Burimi: Grupi i Bankës Botërore, të bërit Biznes 2019: Trajnim për Reforma

Shtylla 9 – Sistemi Financiar

9.01 Kredia e brendshme për sektorin Privat

Vlera totale e burimeve financiare të dhëna për sektorin privat, e shprehur në përqindje të PBB-së. (Mesatarja lëvizëse 2015–2017). Ky tregues llogaritet si shuma e huave, blerjeve të letrave me vlerë jo të kapitalit, kredive tregtare dhe llogarive të tjera të arkëtueshme që krijojnë një pretendim për shlyerje të ofruar nga korporatat financiare për firmat dhe individët.

Burimi: Grupi i Bankës Botërore, Baza e të dhënave të Treguesve të Zhvillimit Botëror (<https://data.worldbank.org/>, aksesuar më 02 prill 2019).

9.02 Financimi i NVM-ve

Përgjigje ndaj pyetjes së pyetësorit “Në vendin tuaj, në çfarë mase mund të kenë akses ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në financat që u nevojiten për operacionet e tyre të biznesit nëpërmjet sektorit financiar?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madh (Mesatarja e peshuar 2018–2019 ose periudha më e fundit e disponueshme).

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

9.03 Disponueshmëria e kapitalit të sipërmarrjes

Përgjigje ndaj pyetjes së pyetësorit “Në vendin tuaj, sa është e lehtë për sipërmarrësit fillestarë me projekte inovatore por të rrezikshme të marrin fonde të kapitalit?” 1 = jashtëzakonisht e vështirë; 7 = jashtëzakonisht e lehtë (Mesatarja e peshuar 2018–2019 ose periudha më e fundit e disponueshme).

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

9.04 Kapitalizimi i tregut

Vlera totale e kompanive vendëse të listuara, e shprehur në përqindje të PBB-së (Mesatarja lëvizëse 2014–2016). Llogaritur si çmimi i aksioneve të të gjitha kompanive vendëse të listuara shumëzuar me numrin e aksioneve të tyre në qarkullim. Përfshihen fondet e investimeve, trustet e njësive dhe kompanitë, qëllimi i vetëm i biznesit të të cilave është të mbajnë aksione të kompanive të tjera të listuara. Të dhënat janë vlera të fundvitit.

Burimet: Grupi i Bankës Botërore, databaza e treguesve të zhvillimit botëror (<https://data.worldbank.org/>, aksesuar më 02 prill 2019) dhe Baza e të dhënave për Zhvillimin Financiar Global (botimi i korrikut 2017); burimet kombëtare.

9.05 Premitë e sigurimit

Vëllimet e primeve të sigurimit të jetës dhe jojetës, të shprehura në përqindje të PBB-së. Mesatarja lëvizëse 2014–2016, llogaritur si shuma e vëllimit të primeve të sigurimit të jetës dhe jojetës, pjesëtuar me PBB-në. Vëllimi i primit janë primit direkte të siguruesit të fituara (nëse është pronë/viktimë) ose të marra (nëse jetë/shëndeti) gjatë vitit të kaluar kalendarik.

Burimi: Grupi i Bankës Botërore, Baza e të Dhënave për Zhvillimin Financiar Global (botimi 2017); burimet kombëtare.

9.06 Qëndrueshmëria e bankave

Përgjigja ndaj pyetjes së pyetësorit “Në vendin tuaj, si e vlerësoni qëndrueshmërinë e bankave?” 1 = jashtëzakonisht e ulët—bankat mund të kërkojnë rikapitalizim; 7 = jashtëzakonisht e lartë—bankat janë përgjithësisht të qëndrueshme me bilanc të shëndoshë. Mesatarja e peshuar 2018–2019 ose periudha më e fundit e disponueshme.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinionit Ekzekutiv (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

9.07 Kreditë me probleme (joperformuese)

Raporti i vlerës së kredive me probleme pjesëtuar me vlerën totale të portofolit të kredisë të të gjitha bankave që operojnë në një vend | Kreditë me vonesë të vitit 2017 janë pagesa të interesit dhe të principalit të vonuara 90 ditë ose më shumë. Shuma e kredisë e regjistruar si joperformuese përfshin vlerën bruto të huasë siç është regjistruar në bilanc, jo vetëm shumën e vonuar.

Burimet: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Treguesit e shëndetit financiar (data.imf.org/FSI, aksesuar më 29 mars 2019); Grupi i Bankës Botërore, Baza e të Dhënave të Zhvillimit Financiar Global (qasur më 28 mars 2019); burimet kombëtare.

9.08 Hendeku i kredisë

Mat diferencën midis raportit të kredisë ndaj PBB-së dhe prirjes së tij afatgjatë | 2017 Llogaritur si diferencë midis “Kredisë së brendshme për sektorin privat (në përqindje të PBB-së)” më të fundit dhe tendencës së saj. Sipas metodologjisë së Bankës së Shlyerjeve Ndërkombëtare, vlera e trendit llogaritet duke aplikuar një filtër Hodrick–Prescott në serinë kohore 15-vjeçare të treguesit “Kredia e brendshme për sektorin privat (% e PBB-së)”.

Më shumë detaje rreth metodologjisë mund të gjenden në https://www.bis.org/publ/qtrpdf/r_qt1403g.htm. Për shkak të konvertimit të veçantë të aplikuar për këtë tregues, renditja për këtë tregues bazohet në rezultatet e progresit dhe jo në vlerat e papërpunuara.

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në Bankën Botërore, databaza e Treguesve të Zhvillimit Botëror (<https://data.worldbank.org/>, aksesuar më 02 prill 2019).

9.09 Raporti i kapitalit rregullator të bankave, përqindja e aktiveve totale të ponderuara me rrezik

Raporti i kapitalit rregullator të bankave (Mesatarja lëvizëse 2015–2017). Ky tregues mat mjaftueshmërinë e kapitalit të depozituesve. Ai është një raport i totalit të kapitalit rregullator të bankave (kapitali i aksionarëve, rezervat e shpalosura dhe të padeklaruara, rezervat e rivlerësimit, provizionet e përgjithshme dhe instrumentet e tjera) ndaj totalit të aktiveve të bankave, i peshuar sipas rrezikut të këtyre aseteve aktive. Një transformim regjistri zbatohet në rezultatin e papërpunuar përpara se të normalizohet në një shkallë nga 0 në 100.

Burimet: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Treguesit e shëndetit financiar (data.imf.org/FSI, aksesuar më 29 mars 2019); Grupi i Bankës Botërore, Baza e të Dhënave të Zhvillimit Financiar Global (qasur më 28 mars 2019); burimet kombëtare.

Shtylla 10: Madhësia e tregut

10.01 Produkti i Brendshëm Bruto

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) i vlerësuar në barazinë e fuqisë blerëse në miliarda dollarë ndërkombëtare (çmimet konstante të vitit 2011) | 2018 ose periudha më e fundit e disponueshme.

Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, baza e të dhënave World Economic Outlook (botimi i prillit 2019).

10.02 Importet e mallrave dhe shërbimeve

Importet e mallrave dhe shërbimeve, të shprehura në përqindje të PBB-së (2017). Ky tregues ilustron vlerën e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të tjera të tregut të marra nga pjesa tjetër e botës, si përqindje e PBB-së së vendit. Importet përfshijnë vlerën e mallrave, mallrave, sigurimit, transportit, udhëtimit, honorarët, tarifat e licencës dhe shërbime të tjera, si: komunikimi, ndërtimi, shërbimet financiare, informacioni, biznesi, personale dhe qeveritare. Ato përjashtojnë kompensimin e punonjësve dhe të ardhurat nga investimet (më parë të quajtura "shërbime faktori") dhe pagesat e transfereve.

Burimi: Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), Baza e të dhënave të Statistikave të OBT-së, aksesuar më 01 maj 2019.

Shtylla 11: Dinamizmi i biznesit

11.01 Kostoja e fillimit të një biznesi

Shprehur si përqindje e të ardhurave të ekonomisë për kokë banori, 2018.

Shpenzimet përfshijnë të gjitha tarifat zyrtare dhe tarifat për shërbime ligjore apo profesionale, nëse këto shërbime kërkohen me ligj apo përdoren zakonisht në praktikë. Tarifat për blerjen dhe legalizimin e pasqyrave kontabël të kompanive përfshihen nëse këto transaksione kërkohen me ligj. Edhe pse regjistrimi për tatimin mbi vlerën e shtuar mund të llogaritet si një procedurë e veçantë, tatimi mbi vlerën e shtuar nuk është pjesë e kostonë së përfshirjes. Më shumë detaje rreth metodologjisë mund të gjendet në: [http://www.doingbusiness.org/Metodologjia/Fillimi i një biznesi](http://www.doingbusiness.org/Metodologjia/Fillimi_i_nj_e_biznesi).

Burimi: Grupi i Bankës Botërore, Të Bërit Biznes, 2019: Trajnim për Reforma.

11.02 Koha për të filluar një biznes

Numri i ditëve kalendarike që nevojiten për të përfunduar procedurat për të drejtuar ligjërisht një biznes (2018).

Kjo masë kap kohëzgjatjen mesatare të atij inkomporomi; avokatët ose noterët tregojnë se është e nevojshme në praktikë për të plotësuar një procedurë me korrespondencë minimale me agjencitë qeveritare dhe pa pagesa jozyrtare. Nëse një procedurë mund të përshpejtohet në kostonë shtesë, procedura më e shpejtë, e pavarur nga kostoja është zgjedhur. Më shumë detaje rreth metodologjisë mund të gjenden në:

<http://www.doingbusiness.org/Methodology/Starting-a-Business>.

Burimi: Grupi i Bankës Botërore, Të Bërit Biznes 2019: Trajnim për Reforma.

11.03 Shkalla e rikuperimit nga falimentimi

Regjistruar si centë në dollarin e rikuperuar nga kreditorët e siguruar nëpërmjet riorganizimit gjyqësor, likuidimit ose procedurat përmbarese të borxhit (foreclosure ose marrjes në pronësi) 2018.

Llogaritja merr parasysh rezultatin, qoftë kur biznesi del nga procedurat si çështje në vazhdim apo kur pasuritë shiten pjesë-pjesë. Pastaj shpenzimet e procedurës zbriten (1 cent për çdo pikë përqindje të vlerës së pasurisë së debitorit). Në fund vlera e humbur, si rezultat i kohës, paratë mbesin të lidhura në procedurat e falimentimit, merren parasysh. Më shumë detaje rreth metodologjisë mund të gjenden në:

<http://www.doingbusiness.org/Methodology/Resolving-Insolvency>.

Burimi: Grupi i Bankës Botërore, Të Bërit Biznes 2019: Trajnim për Reforma.

11.04 Korniza rregullatore e falimentimit

Pikët në një indeks që matin përshtatshmërinë dhe integritetin e kornizës ligjore të aplikueshme për likuidimin dhe masat e riorganizimit. Pikët variojnë nga 0 në 16, me vlera të larta që tregojnë legjislacionin e falimentimit i cili është i dizajnuar më mirë për rehabilitimin e firmave funksionale dhe likuidimin e atyre jofunksionale (2018).

Indeksi llogaritet si shumë e pikëve në fillim të procedurave të indeksit; indeksi i menaxhimeve të aseteve të debitorit, indeksi i procedurave të riorganizimit dhe indeksi i pjesëmarrjes së kreditorit. Më shumë detaje rreth metodologjisë mund të gjendet në <http://www.doing-business.org/Methodology/Resolving-Insolvency>.

Burimi: Grupi i Bankës Botërore, Të Bërit Biznes 2019: Trajnim për Reforma.

11.05 Qëndrimet ndaj rrezikut të sipërmarrjes

Përgjigje në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, për çfarë kanë njerëzit motiv për rrezikun sipërmarrës?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe | 2018–2019 e ponderuar periudha mesatare ose më e fundit në dispozicion.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinionit Ekzekutiv (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

11.06 Gatishmëria për të deleguar autoritetin

Përgjigje në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, në çfarë mase menaxhmenti i lartë i delegon autoritetin vartësve?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe; 2018 – 2019 e ponderuar periudha mesatare ose periudha më e fundit në dispozicion.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinionit Ekzekutiv (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

11.07 Rritja e kompanive inovative

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, për çfarë rriten me shpejtësi kompanitë e reja me ide inovative?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe, 2018–2019 e ponderuar periudha mesatare ose periudha më e fundit në dispozicion

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (botime të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

11.08 Kompanitë që përqafojnë ide ndryshuese

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, për çfarë mase kompanitë përkrahin rrezikun ose idetë “disruptive?” ndryshuese 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe; 2018–2019 mesatare e ponderuar ose periudha më e fundit në dispozicion.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

Shtylla 12: Aftësia për inovacion

12.01 Diversiteti i fuqisë punëtore

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, në çfarë mase kompanitë kanë fuqi punëtore diverse (p.sh. për sa i përket etnisë, fesë, orientimit seksual, gjinisë)?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe; 2018–2019 mesatarja e ponderuar ose periudha e fundit në dispozicion.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

12.02 Gjendja e zhvillimit të grupimeve

Përgjigjja në pyetjen e anketës “Në vendin tuaj, sa janë të përhapura grupimet e zhvilluara mirë dhe të thella (gjeografike, përqendrimet e firmave, furnitorëve, prodhuesve të lidhura me produktet dhe shërbimet, si dhe institucionet e specializuara në një fushë të veçantë)?” 1 = nuk ekzistojnë; 7 = e përhapur në shumë fusha. Mesatarja e ponderuar 2018–2019 ose periudha më e fundit në dispozicion.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

12.03 Bashkëshpikjet ndërkombëtare për një milion banorë

Numri i aplikimeve të familjes për patentë, me bashkëshpikës që gjenden jashtë vendit për një milion banorë. Mesatarja 2013–2015.

Llogaritur si shuma e aplikimeve të kategorisë së patentave me të paktën një bashkëshpikës që gjendet jashtë vendit, i paraqitur në të paktën dy prej pesë zyrave kryesore (IP5) në botë: Zyra Evropiane e Patentave (EPO), Zyra e Patentave Japoneze (JPO), Zyra Koreane e Pronës Intelektuale (KIPO), Zyra Shtetërore e Pronësisë Intelektuale të Republikës Popullore të Kinës (SIPO), Zyra e Patentave dhe Markave të Shteteve të Bashkuara (USPTO). Të dhënat janë nxjerrë nga baza e të dhënave PATSTAT sipas datës më të hershme të paraqitjes dhe vendit të shpikësit,

duke përdorur numërimin e pjeshëm dhe të shprehur në aplikime për milion kokë banori. Një log transformimi zbatohet në rezultatin e papërpunuar më parë, përpara se të normalizohet në një shkallë nga 0 deri në 100.

Burimi: Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimi (OECD), IST Laboratori i të dhënave mikro: baza e të dhënave të pronësisë intelektuale, (<http://oe.cd/ipstats>, maj 2019).

12.04 Bashkëpunimi me shumë palë

Pika mesatare e tre pyetjeve në vijim të pyetjeve të anketës të Opinioni Ekzekutiv: “Në vendin tuaj, deri në çfarë mase njerëzit bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë ide brenda një kompanie?” 1 = jo në të gjitha; 7 = në një masë të madhe; “Në vendin tuaj, deri në çfarë mase kompanitë bashkëpunojnë për të ndarë idetë dhe për të bërë shpikje?” 1 = aspak; 7 = në një masë të madhe; “Në vendin tuaj, deri në çfarë shkalle bizneset dhe universitetet bashkëpunojnë në kërkime dhe zhvillim (R&D)?” 1 = nuk bashkëpunojnë fare; 7 = bashkëpunojnë gjerësisht. 2018–2019 mesatarja e ponderuar ose periudha e fundit në dispozicion.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioni Ekzekutiv (botime të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

12.05 Publikime shkencore

Mat numrin e publikimeve dhe citimet e tyre, të shprehura në nivel vendi. Mesatarja 2016–2018.

Indeksi mat numrin e punimeve të botuara të cituara në artikuj të tjerë shkencorë të paktën h herë. Indeksi H i pasqyron të dyja numrin e publikimeve dhe numrin e citimeve për publikim. Përfshihen vetëm artikujt, rishikimet dhe artikujt e konferencave. Grupi i dokumenteve përcaktohet nga ato që gjurmohen nga Scopus-i, që është një bazë e të dhënave me abstrakte dhe citime të rishikuara, e që përfshihen: revistat shkencore, librat dhe punimet e konferencave. Një transformim i regjistrit zbatohet në rezultatin e papërpunuar para se të jetë, normalizohet në një shkallë nga 0 deri në 100.

Burimi: SCImago, Journal & Country Rank (<http://www.scimagojr.com/countryrank.php>, aksesuar më 16 qershor 2019).

12.06 Aplikimet për patentë

Numri i përgjithshëm i aplikimeve për kategorinë e patentës familjare për 1 milion kokë banori. Mesatarja 2013–2015.

Llogaritur si shuma e aplikimeve për kategorinë e patentës të paraqitura në të paktën në dy nga pesë zyrat kryesore të patentës (IP5) në botë: siç janë: Zyra Evropiane e Patentave (EPO), Zyra e Patentave Japoneze (JPO), Zyra Koreane e Pronësisë Intelektuale (KIPO), Zyra Shtetërore e Republikës Popullore të Kinës për Pronësi Intelektuale (SIPO) dhe Zyra e Shteteve të Bashkuara për Patentat dhe Markat (USPTO). Të dhënat nxirren nga baza e të dhënave PATSTAT sipas datës më të hershme të paraqitjes dhe vendit të shpikësit, duke përdorur numërimin thyesor dhe të shprehur si aplikime për 1 milion kokë banori. Një transformim regjistri zbatohet në rezultatin e papërpunuar përpara se të normalizohet në një shkallë nga 0 deri në 100.

Burimi: Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimi (OECD), IST Micro-data Lab: baza e të dhënave për Pronësinë Intelektuale (<http://oe.cd/ipstats>, maj 2019).

12.07 Shpenzimet për R&D

Shpenzimet për kërkimin dhe zhvillimin (R&D), të shprehura si përqindje e PBB-së. 2016 ose viti më i fundit i disponueshëm.

Shpenzimet për kërkimin dhe zhvillimin janë shpenzime aktuale dhe kapitale (si publike ashtu edhe private) për punën krijuese që ndërmerren në mënyrë sistematike për të rritur njohuritë— duke përfshirë njohuritë e njerëzimit, kulturës dhe shoqërisë, si dhe përdorimin e njohurisë për aplikime të reja. Kërkimi dhe zhvillimi mbulon hulumtimin bazik, hulumtimin e aplikuar dhe zhvillimin eksperimental.

Burimi: Banka Botërore, Baza e të dhënave të Treguesve të Zhvillimit Botëror (<https://data.worldbank.org/>, aksesuar më 24 prill 2019).

12.08 Ngritja e institucioneve kërkimore

Mat rëndësinë dhe pozitën e institucioneve kërkimore private dhe publike. | 2019 Rezultati është llogaritur si shuma e renditjes së kundërt të të gjitha institucioneve kërkimore në një vend të përfshirë në renditjet e institucioneve SCImago (SIR). Ai përfshin universitete private dhe publike, agjenci qeveritare, entitete korporative dhe institute shëndetësore. Një transformim log zbatohet në rezultatin e papërpunuar përpara se të normalizohet në një shkallë nga 0 deri në 100.

Më shumë detaje rreth metodologjisë SIR mund të gjenden në:

<https://www.scimagoir.com/metodology.php>.

Burimi: Llogaritjet e Forumit Ekonomik Botëror bazuar në SCImago (<https://www.scimagoir.com/>, aksesuar më 16 qershor 2019).

12.09 Përsosmëria e blerësit

Përgjigjja ndaj pyetjes së pyetësorit "Në vendin tuaj, mbi çfarë baze marrin blerësit vendimet për blerjen?" 1 = bazuar vetëm në çmimin më të ulët; 7 = bazuar në atributet e sofistikuara të performancë. Mesatarja e peshuar 2018–2019 ose periudha më e fundit e disponueshme.

Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, Anketa e Opinioneve Ekzekutive (edicione të ndryshme). Për më shumë detaje, referojuni Shtojcës B të këtij raporti.

12.10 Aplikacionet për marka tregtare

Numri i aplikacioneve për marka tregtare për milion banorë. Mesatarja lëvizëse 2015–2017. Numri i aplikacioneve për marka ndërkombëtare të lëshuara drejtpërdrejt ose përmes Sistemit të Madridit sipas vendit të origjinës për milion banorë. Vendbanimi i aplikantit me emrin e parë përdoret për të përcaktuar origjinën e një aplikacioni. Kur ka shumë aplikantë, merret parasysh vetëm i pari. Ky tregues bazohet në konceptin e "numërimit ekuivalent". Kjo do të thotë, një aplikim i paraqitur në një zyrë rajonale IP llogaritet disa herë sipas numrit të anëtarëve të tij. Një transformim log zbatohet në rezultatin e papërpunuar përpara se të normalizohet në një shkallë nga 0 deri në 100.

Burimi: Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, databaza e statistikave WIPO (<https://www3.wipo.int/ipstats/lpsStatsResultvalue>, dhjetor 2018).

SHTOJCA 3: METODOLOGJIA

Gjatë 40 viteve të fundit, Sondazhi i Opinioneve Ekzekutiv ka qenë përbërës kryesor i Raportit Global të Konkurrueshmërisë (Global Competitiveness Report) dhe aktiviteteve të tjera konkurruese në Forum. Është sondazhi më afatgjatë dhe i gjerë i këtij lloji, i cili ofron një vlerësim vjetor në aspektet kritike të konkurrueshmërisë për të cilën mungojnë të dhëna statistikore, sepse është ose e pamundur ose shumë e vështirë të matet në nivel global. Qëllimi i sondazhit është që sa më mirë të kap realitetin, dhe liderët e bizneseve janë pa dyshim në pozicionin më të mirë për të vlerësuar ambientin biznesor në të cilin operojnë.

Përgjatë sondazhit të anketuarit kërkohen të vlerësojnë situatën në fusha specifike në nivel shtetëror, siç është oreksi për rrezik të sipërmarrjes, niveli i korrupsionit dhe shtrirja e hendekut të aftësive. Rezultatet e sondazhit i plotësojnë të dhënat e tjera statistikore për të ofruar një vlerësim të plotë të mjedisit biznesor dhe shtyesve të produktivitetit.

Indikatorët e marrë nga Sondazhi përdoren në kalkulimin e Indeksit Global të Konkurrueshmërisë (Global Competitiveness Index) 4.0 (GCI 4.0), përveç indekseve të tjera në kuadër të Forumit Ekonomik, siç janë Indeksi Global i Hendekut Gjnor dhe Indeksi i Konkurrueshmërisë në Udhëtim dhe Turizëm; dhe në shumë publikime duke përfshirë Raportin Gjithëpërfshirës të Rritjes dhe Zhvillimit dhe Raportin Global të Rrezikut, si dhe në shumë aktivitete të Forumit. Si një burim unik të dhënash, sondazhi është përdorur nga shumë organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare, think tanks dhe akademi për vepra empirike dhe politike.

Struktura e sondazhit, administrata dhe metodologjia

Sondazhi përmban 78 pyetje. Shumica e pyetjeve pyesin të anketuarin të vlerësojnë performancën në tema të ndryshme sipas vendit në të cilin operojnë në shkallën nga 1 (e konsideruar si më e keqja në botë) deri në 7 (konsideruar si më e mira në botë). Pyetjet janë të organizuara në 10 Shtylla: Infrastrukturë; Teknologji; Mjedis Financiar; Tregtia e Jashtme dhe Investimet; Konkurrenca Vendore; Operimet Biznesore dhe Inovacioni; Siguria; Edukimi dhe Resurset Humane; Qeverisja dhe Rreziqet.

Korniza mostër duhet të reflektojë strukturën e ekonomisë si në vazhdim:

- Duhet të jetë proporcionale me peshën e BPV apo PBB për sektor: agrikulturë, industri prodhuese, industri joprodhuese (minierë, gurorë, elektricitet, furnizim me gaz dhe ujë, ndërtimtari) dhe servise;
- Duhet të sigurojë përfaqësimin e kompanive të mëdha (me më shumë se 250 punëtorë) dhe atyre të vogla (250 punëtorë apo më pak), sërisht duke reflektuar mbi secilin sektor. Të paktën një e treta e kompanive janë të mëdha dhe një e treta janë të vogla, pjesa tjetër që mbetet, janë të përcaktuara nga struktura e ekonomisë në proporcion me BPV-në për madhësi të kompanisë.
- Duhet të sigurojë se kompanitë e zgjedhura të kenë mbulim të gjerë gjeografik.

Institutet Partnere kërkohen të ndajnë kornizën e sondazhit në dy lista: njëra që përfshin vetëm firmat e mëdha dhe e dyta që përfshin të gjitha firmat e tjera, duke mbajtur përfaqësim sektorial në

dy listat. Pastaj institucionet partnere në mënyrë të rëndomtë zgjedhin nga secila listë firmat që do ta pranojnë sondazhin.

Trajtimi i të dhënave dhe llogaritja e pikëve

Kjo pjesë tregon në detaje procesin ku të gjitha përgjigjet individuale editohen dhe grumbullohen për të prodhuar pikët e sondazhit në secilin shtet. Këto rezultate së bashku me indikatorët e tjerë të marrë nga burime e tjera futen në GCI 4.0 dhe projektet e tjera hulumtuese.

Editimi i të dhënave

Para grumbullimit, të dhënat në nivel të anketuarve bëhen pjesë e një procesi të kujdesshëm editimi. Përgjigjet në vazhdim largohen nga databaza: anketat ku anketuesi jep përgjigjen e njëjtë në 80% të pyetjeve, anketat me shkallë të plotësimi më pak se 50%, anketuesit që nuk janë të bazuar në të njëjtin vend si Instituti Partner; anketuesit që nuk kanë moshën minimale të kërkuar dhe sondazhet dublikate, e cila mund të ndodhë nëse sondazhi është plotësuar edhe online edhe është dërguar në email.

Pastaj llogarisim diapazonin ndër kuartil (p.sh diferencën mes kuartilit të 25-të me atë të 75-të). Çdo vlerë jashtë rangut të kufizuar nga kuartili i 25-të minus 1.5 herë IQR dhe kuartili i 75-të plus 1.5 herë IQR, është i identifikuar si *outlier potencial*. Ky test plotësohet nga një sërë testesh empirike, duke përfshirë analizën e trendit pesëvjeçar dhe një krahasim të ndryshimeve në rezultatet e sondazhit me ndryshimet e indikatorëve të tjerë që kapin koncepte të njëjta. Ne i intervistojmë ekspertët lokalë dhe konsiderojmë zhvillimet më të fundit në vend për të vlerësuar besueshmërinë e rezultateve të sondazhit.

Llogaritja e edicionit të parë të pikëve në shtet

Ne përdorim mesataren e thjeshtë për të llogaritur pikët në nivel shtetëror. Ashtu siç korniza e mostrës synon të replikojë përbërjen sektoriale të një ekonomie dhe përfshin kompani të madhësive të ndryshme, niveli shtetëror i pikëve të secilit sondazh i opinionit ekzekutiv është mesatarja aritmetike e përgjigjeve në secilin shtet. Pra, për secilën pyetje, të gjitha përgjigjet individuale kanë peshë të njëjtë. Formalisht, mesatarja e një indikatorit të sondazhit i në shtetin c shënohet $q_{i,c}$ dhe llogaritet si më poshtë:

$$q_{i,c} = \frac{\sum_j^{N_{i,c}} q_{i,c,j}}{N_{i,c}}$$

ku $q_{i,c}$ është përgjigjja e pyetjes i në shtetin c nga anketuesi j; dhe $N_{i,c}$ është numri i të anketuarve të pyetjes i në shtetin c.

Pasi përgjigjet grumbullohen në nivel shtetëror, kryhet një test për të zbuluar nëse ka *outliers* statistikore. Ne e shfrytëzojmë marrëdhënien e fortë mes indikatorëve të nxjerrë nga sondazhi dhe 50 indikatorëve të përfshirë në GCI 4.0: shtetet që performojnë mirë në këta indikatorë, performojnë mirë dhe në sondazh. Një regresion njëndryshor linear përdoret për të parashikuar pikët mesatare të pritshme të indikatorëve të sondazhit duke u bazuar në mesataren e performancës në indikatorët e tjerë. Pikët mesatare të sondazhit që bien jashtë intervalit konfidencial 90% rreth vlerës së parashikuar, konsiderohen "outliers". Pikët individuale të indikatorëve të sondazhit rregullohen në mënyrë sistematike nga një faktor korrespondues i distancës mes mesatares së observuar të pikëve të sondazhit dhe mesatares së parashikuar në limitin e intervalit konfidencial.

Shtesë bëhet një analizë për të vlerësuar besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e të dhënave të sondazhit me kalimin e kohës. Si pjesë e analizës përdoret një rang ndër-kuartil (IQR) me qëllim të identifikimit të lëkundjeve të mëdha pozitive dhe negative mes dy edicioneve. Për secilin shtet janë llogaritur dallimet nga vitet paraprake me vitin 2019, si pikë mesatare e 53 pyetjeve të anketës.

SHTOJCA 4: REFERENCAT

Riinvest (2023). Zhvillimi i kërkimeve dhe inovacionit në Kosovë, Raport studimor, Instituti Riinvest.

Schwab, Klaus dhe Zahidi, Saadia (2021). How Countries are Performing on the Road to Recovery. The Global Competitiveness Report 2020, Special Edition, World Economic Forum (WEF). Linku: <https://www.weforum.org/reports/the-global-competitiveness-report-2020>

World Economic Forum (2019). The Global Competitiveness Report 2019. World Economic Forum. Linku: https://www3.weforum.org/docs/WEF_TheGlobalCompetitivenessReport2019.pdf

World Economic Forum (2020). The Future of Jobs Report 2020. World Economic Forum. Linku: <https://www.weforum.org/reports/the-future-of-jobs-report-2020>

World Economic Forum (WEF) (2019). Methodology and Computation of the Global Competitiveness Index 2017–2018. World Economic Forum. Linku: <https://www3.weforum.org/docs/GCR2017-2018/04Backmatter/TheGlobalCompetitivenessReport2017%E2%80%932018AppendixA.pdf>

POZITA E EKONOMISË SË KOSOVËS NË KONKURRENCËN GLOBALE

2023

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Bahri Koskoviku

Redaktor teknik:

ASHAK

Madhësia: 16 tabakë shtypi

Tirazhi: 300 copë

Formati: 23x28 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

Katalogimi në shtyp – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

339(496.51)

Pozita e ekonomisë së Kosovës në konkurrencën globale / ekipi i projektit Justina Shiroka-Pula ... [etj.]. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2023. - 128 f. : ilustr. ; 28 cm.

- | | | |
|--------------------------|---------------------|-------------------|
| 1. Shiroka-Pula, Justina | 2. Mustafa, Isa | 3. Islami, Hivzi |
| 4. Krasniqi, Besnik | 5. Mustafa, Muhamet | 6. Hashani, Alban |
| 7. Kryeziu, Liridon | 8. Beqiri, Gent | |

ISBN 978-9951-26-070-1

